



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 42 Datë 13 . 06 2023

“Për miratimin e mandateve të Këshilltarëve”

Mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 48, **Mbledhja e parë e këshillit bashkiak**, pika 5, *Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë*; pika 6, gërma b) *miratohen mandatet e anëtarëve të këshillit*, gërma c) *këshilltarët bëjnë betimin*, pika 7) *Këshilli konstituohet pas vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij*; neni 50, **Betimi**; neni 54, **Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak**, gërma j) *vendos për dhënien ose deklarimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 49 të këtij ligji*; neni 55, pika 3, *Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji*; Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e tij të parë;

VENDOSI:

1. Miratimin e mandateve të këshilltarëve, sipas listës bashkëngjitur, mbështetur në nenin 55, pika 3.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Ardian ÇELEPIJA

Këshilltari më i vjetër në moshë
Frano Prenga

Miratuar me 28 vota

Vota Pro 28

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 16.06.23